



Sedat Islami

Debati për historinë dhe rishkruarjen e saj këto ditë u ndez prapë. Shkas, përveç petitionit të nënshkruar nga ana e tij kundër ndryshimit të historisë, ishte një intervistë e Ismail Kadaresë e dhënë në Gjermani. Ishte, si të thuash, një “zbulim”, një teori e panjohur deri më tani. Ai mohon të na kenë mbrojtur osmanët nga sllavët. E konsideron këtë si sajësë historike, si shpifje, si fantazi makabër...Përkundrazi, ai e mendon të kundërtën.

Por, a ka dëgjuar Isi, siç parapëlqen të thirret, për Branko Manojlovskin, këtë njeri që “aksidentalisht” i është bashkëngjitur debatit për historinë dhe rolin e Perandorisë Osmane në ruajtjen e kombit shqiptar?

A ka dëgjuar rrëfimin e tij për shqiptarët ortodoksë dhe fatin e tyre?

Nëse jo, atëherë Brankon do ta prezantojë në vetën e parë. Do ta citoj që të na rrëfen për fatin e atyre shqiptarëve që ngelën si ortodoksë. Branko është shqiptar, por është asimiluar.

“Po, unë emnin e kom Branko Manojllovski, po jam shiptar, ortodoks shiptar ma mirë me thanë. Ka ni vend qi thirret Reka Epërme, është Rrethi Dibrës dhe ka nja shtatëmdhetë katunde si folin shyp me mija vjet, mirëpo mas ni kohe e ndrran e u asimillun e u bonë slloven (sllav).”

Pra, shqiptarët ortodoksë tanimë nuk e ndiejnë veten shqiptarë. Ata ndihen si sllav, dhe jo vetëm kaq. Ata nuk duan të ndihen si shqiptarë.

“E dinjin ata, ma rahat ju vinte t’jen maqedon. Ma rahat rronjin aty ndërmnjjet ata ihsan. Asimillimi t’thash, osht fuqi e madhe dhe nuk ka zemër asimillimi. Nuk ka, si thuhet “oseqaj” – nuk ka ndjenjë. Shkon, t’mer ndërkomb edhe t’mbytën.”

“...dhe interesant osht se shumë njerëz e morët vesht, pak nervoz jon, po e din se aty jom, e din se jon shyptarë.

Janë nervoz, kush janë?

Popullata ortodokse shyptare jon nervoz, se jon martu me maqedon, me sërë me bugarë e me kto me kto, s'din kit bojn tash, mirëpo Brenda në zemret e dinë se une e kom me hak – e shohi une ato, reaksinë e ihsanit (njerzve).”

Branko, ndryshe nga shumë të tjerë, vazhdon ta ndiejë veten shqiptarët, por nuk fsheh, siç pamë, të vërtetën e asimilimit dhe shkrirjes së shumicës shqiptare ortodokse në popullatën maqedonase.

Atëherë, përse këta u shkrinë në maqedonas dhe jo shqiptarët myslimanë? Përse Isi vazhdon të mohojë të vërtetat? Përse Isi nuk shërbehet me këto fakte të gjalla por i referohet historisë së sajuar? Përse Isi nuk pranon kontributin e pakrahasueshëm të Islamit në ruajtjen e vetëdijes sonë kombëtare?

Akoma më e paqartë mbetet pse Kadareja dhe të tjerë nuk mund t'i paramendojnë shqiptarët si myslimanë në Evropë. Athua vallë feja islame po na pengon nga integrimi? Evropa nuk mendon kështu.

Referenca:

<http://botasot.info/lajme/227990/kadare-pushtimi-osman-nuk-i-ka-mbrojtur-shqiptaret-nga-sllavet/>

<http://standardi.info/index.aspx?SID=13&LID=2&AID=85716&Ctype=1&ACatID=11>

<http://www.zeri.info/artikulli/7865/me-thone-branko-manojlovski-por-une-jam-shqiptar>

<http://www.zeri.info/artikulli/7922/ata-turqe-ne-kaure>

<http://www.botasot.info/kultura/217596/kadare-turqia-po-ben-agresion-kulturor/>